



Republika e Kosovës
Republika Kosovon - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura V

Sesioni pranveror

Nënkomisioni për Mandate, Imunitete dhe Rregulloren e Kuvendit

Mbledhja, nr. 01

Prishtinë, më 10.4.2015, në orën 11:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla N302

PROCESVERBAL

I mbledhjes së Nënkomisionit për Mandate, Imunitete dhe Rregulloren e Kuvendit

Në mbledhje morën pjesë: Armend Zemaj, Albulena Haxhiu, Danush Ademi, Donika Kadaj-Bujupi dhe Enver Hoti.

Mungoi: Selville Halimi.

Të ftuar dhe pjesëmarrës të tjerë: Rinor Beka dhe Shefki Kastrati – NDI, Floriana Merovci-ZPRK dhe Valmire Hoti-Infodirekt.TV.

Nga Stafi Mbështetës i Komisionit: Visar Krasniqi.

Mbledhjen e kryesoi: Armend Zemaj, kryetar i Nënkomisionit.

Për këtë mbledhje u propozua ky rend i ditës:

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Përfundimi i Kryesisë së Kuvendit Nr. 05-P-021;
3. Të ndryshme.

Kryesuesi konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës dhe e hapi mbledhjen me shqyrtimin e pikës së parë të rendit të ditës.

1. Miratimi i rendit të ditës;

Rendi i ditës u miratua pa ndryshime.

2. Përfundimi i Kryesisë së Kuvendit Nr. 05-P-021;

Armend Zemaj, kryetar, i njoftoi anëtarët e Komisionit se me Përfundimin e Kryesisë së Kuvendit Nr. 05-P-021, është ngarkuar Komisioni për Legjislacion, Mandate, Imunitete, Rregulloren e Kuvendit dhe mbikëqyrjen e Agjencisë Kundër Korrupsionit, që gjatë sesionit pranveror ta hartojë Projektligjin dhe rregulloren e punës. Meqë tani është themeluar Nënkomisioni, Zemaj tha se sot do të diskutojmë në parim se si do të procedojmë pasi që çdo legjislaturë kërkohet ta ketë rregulloren e vetë të punës. Ajo që duhet sqaruar në fillim është se a do të punojmë në draftin e rregullores që kemi punuar në mandatin e kaluar apo në draftin që ka hartuar projekti i binjakëzimit. Sa i përket Projektligjit për Kuvendin, duhet shikohet se si do t'i qasemi sepse ky Projektligj prek disa ligje në fuqi.

Albulena Haxhiu, Enver Hoti dhe Donika Kada-Bujupi, diskutuan për mënyrën e procedimit të Projektligjit dhe projekt-rregulloren e punës dhe ishte një pajtim i përgjithshëm se duhet të punohet paralelisht në këto dy dokumente. Ata diskutuan edhe për mënyrën e procedimit dhe qasjen e subjekteve tjerë që mund ta ndihmojnë punën e Nënkomisionit dhe u kërkua që në takimet e radhës të ftohen përfaqësuesit e subjekteve që kanë shprehur gatishmërinë për ta mbështetur punën e Nënkomisionit..

Pas diskutimeve, anëtarët e Nënkomisionit u pajtuan që në takimin e radhës, pasi të analizohen dokumentet që kanë pranuar do të merret edhe nisma nga Komisioni për Legjislacion, Mandate, Imunitete, Rregulloren e Kuvendit dhe mbikëqyrjen e Agjencisë Kundër Korrupsionit, për hartimin e Projektligjit dhe rregullores sipas përfundimit të Kryesisë Nr. 05-P-021.

3. Te ndryshme.

Për këtë pikë të rendit të ditës nuk pati diskutim.

Mbledhja përfundoi në orën 11:40.

E përgatiti:

Stafi Mbështetës i Komisionit

Kryetari i Nënkomisionit

Armend Zemaj